



VENDIM
Nr.100 Datë 07.12.2010

PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORE PËR
PERIUDHËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “b” 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit Nr.77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Vendimit nr.78, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Vendimit nr.5, datë 26.01.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të cmimit të shitjes së energjise elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Vendimit nr.24, datë 11.04.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Vendimit nr.59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Vendimit nr.80, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e Cez Shpërndarja sh.a për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore,

Vendosi :

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjise elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011, sipas tabelës bashkelidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Cmimet e shitjes me pakice per konsumatoret tarifore, te miratuar nga ERE per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2011					
Niveli i Tensionit	Kategorite e Konsumatoreve	Viti 2011			
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi i energjise ne pik (leke/kWh)	Cmimi i energjise reaktive (leke/kWhAr)	
TENSIONI I LARTE	Kliente te Transmetimit TL me asete te zoteruar prej tyre				
	Industri	6.20	6.51	0.93	
	Tregeti & sherbime				
	Bujqesi				
	Te tjere				
	Kliente te furnizuar ne N/S 110 kV te shperndarjes				
	Industri	8.00	8.40	1.20	
	Tregeti & sherbime	8.00	8.40	1.20	
	Bujqesi	8.00	8.40	1.20	
	Te tjere	8.00	8.40	1.20	
TENSIONI I MESEM	Kliente te furnizuar ne 35 kV				
	Industri	8.50	8.93	1.28	
	Tregeti & sherbime	8.50	8.93	1.28	
	Bujqesi	8.50	8.93	1.28	
	Te tjere	8.50	8.93	1.28	
	Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV				
	Industri	9.10	9.56	1.37	
	Tregeti & sherbime	10.00	10.50	1.50	
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	7.46	1.07	
	Bujqesi	8.70	9.14	1.31	
	Te tjere	9.70	10.19	1.46	
	Buxhetore	11.50	12.08	1.73	
	TENSIONI I ULET	Kliente te furnizuar ne TU			
		Industri	10.50		
Tregeti & sherbime		12.20			
Furra buke, prodhim mielli		7.60			
Bujqesi		10.50			
Te tjere		12.00			
Buxhetore		14.00			
Familjare					
Blloku I pare deri ne 300 kWh		7.70			
Blloku I dyte mbi 300 kWh		13.50			
Tarifa fikse e sherbimit te furnizimit per leximin "zero" (leke/muaj)		200			
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)		8.00			
Mesatare Totale		9.53			